

UDHËZIM
Nr. 5, datë 30.12.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E STRUKTURËS PËRGJEGJËSE, ORGANIZIMIN E PUNËS
PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR PAJISJEN ME LICENCË “IMPORT,
EKSPORT, MAGAZINIM DHE VENDOSJE NË TREG TË GAZEVE SERRË TË
FLUORUARA, TË PAJISJEVE QË PËRMBAJNË GAZE SERRË TË FLUORUARA OSE
FUNKSIONIMI I TË CILAVE MBËSHTETET NË KËTO GAZE DHE FORMATIT TË
AKTIT TË MIRATIMIT/REFUZIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 2/2023, “Për gazet serrë të fluoruara”, shkronjës “a” të pikës 5, të kreut II, dhe shkronjës “a” të pikës 3, të kreut III, të aneksit 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Struktura përgjegjëse për shqyrtimin e aplikimeve dhe dokumentacionit shoqërues, për pajisjen me licencë është struktura përgjegjëse e lejeve dhe licencave në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, e cila shqyrton kërkesat për licencë pas miratimit në fazën e parë të shqyrtimit nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, si portë hyrëse për marrjen e kërkesave për pajisjen me licencë “Import, eksport, magazinim dhe vendosje në treg të gazeve serrë të fluoruara, të pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose funksionimi i të cilave mbështetet në këto gaze”, me kodet III.3.B.1 dhe III.3.B.2, shkarkon aplikimet e subjekteve dhe i përcjell ato brenda 2 ditëve pranë strukturës së lejeve dhe licencave në ministrinë përgjegjëse për mjedisin.

3. Për shqyrtimin e kërkesave për pajisjen me licencë, struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat, dhe struktura përgjegjëse për gazet serrë të fluoruara në ministri, ndjekin procedurën si më poshtë:

a) Struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat, brenda 4 (katër) ditëve nga data e administrimit të kërkesës, shqyrton dhe vlerëson kërkesën dhe dokumentet shoqëruese nëse janë në përputhje me kriteret dhe dokumentacionin e parashikuar në VKM-në nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, dhe VKM-në nr. 745, datë 4.12.2024, “Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen me licencë të sipërmarrësve që operojnë në treg me gazet serrë të fluoruara”;

b) Struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat merr mendimin paraprak të strukturës përgjegjëse për gazet serrë të fluoruara në ministri, e cila shprehet brenda ditës;

c) Pas marrjes së mendimit paraprak, struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat brenda 3 ditëve përgatit aktin e miratimit/refuzimit.

4. Ministri, nënshkruan aktin e miratimit/refuzimit për dhënien e licencës brenda 3 (tre) ditëve nga dita e paraqitjes së aktit nga struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat.

5. Afati maksimal për shqyrtimin e kërkesës dhe marrjen e vendimit për aktin e miratimit/refuzimit është 13 ditë nga dita e paraqitjes së aplikimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

6. Në rast se vendimi nuk merret brenda afatit të parashikuar në pikën 5, struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat, para mbarimit të këtij afati, zbaton parashikimet e shkronjës “c”, të pikës 5, të kreut II, të VKM-së nr. 538/2009, të ndryshuar.

7. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, brenda 2 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të miratimit /refuzimit, publikon aktin në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

8. Formati i aktit të miratimit dhe refuzimit të licencave sipas pikës 1, të këtij udhëzimi, janë sipas shtojcave 1/a dhe 1/b bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

9. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

SHTOJCA 1/a



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2024

AKT MIRATIMI
PËR PAJISJEN ME LICENCË “IMPORT, EKSPORT, MAGAZINIM DHE VENDOSJE
NË TREG TË GAZEVE SERRË TË FLUORUARA, TË PAJISJEVE QË PËRMBAJNË
GAZE SERRË TË FLUORUARA OSE FUNKSIONIMI I TË CILAVE MBËSHTETET NË
KËTO GAZE”

Në zbatim të pikës 3, të kreut III, aneksit 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare Të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, dhe VKM-së nr. 745, datë 4.12.2024, “Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen me licencë të sipërmarrësve, që operojnë në treg me gazet serrë të fluoruara dhe pajisjet që përmbajnë këto gaze”, me propozim të strukturës përgjegjëse për licencimin, ministri

VENDOSI:

Miratimin për dhënien e licencës për veprimtarinë “*Importi, eksporti, magazinimi i gazeve serrë të fluoruara, i pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose funksionimi i të cilave mbështetet në këto gaze,*” me kod III.3.B.1 ose/dhe për veprimtarinë “*vendosja në treg e gazeve serrë të fluoruara, të pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose funksionimi i të cilave mbështetet në këto gaze,*” me kodin III.3.B.2, si më poshtë:

1. Nr. i miratimit:

2. Emri i personit fizik/juridik që importon:

NIPT-i:

Adresa (qyteti, rruga nr., etj.):

Nr. i telefonit:

Fax-i ose *email*-i:

Emri i drejtuesit teknik:

3. Data e dhënies së licencës:

4. Me pajisjen e kësaj licence, personi fizik/juridik ka detyrimin për të raportuar pranë strukturës përgjegjëse për gazet e fluoruara në ministri, në mënyrë periodike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për gazet serrë të fluoruara.

MINISTËR

Emër Mbiemër
(firma, vula)

SHTOJCA 1/b



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. ____ prot.

Tiranë, më _____.2024

AKT REFUZIMI

**PËR PAJISJEN ME LICENCË “IMPORT, EKSPORT, MAGAZINIM DHE VENDOSJE
NË TREG TË GAZEVE SERRË TË FLUORUARA, TË PAJISJEVE QË PËRMBAJNË
GAZE SERRË TË FLUORUARA OSE FUNKSIONIMI I TË CILAVE MBËSHTETET NË
KËTO GAZE”**

Në zbatim të pikës 3, të kreut III, të aneksit 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare Të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, dhe VKM-së nr. 745, datë 4.12.2024, “Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen me licencë të sipërmarrësve, që operojnë në treg me gazet serrë të fluoruara dhe pajisjet që përmbajnë këto gaze”, me propozim të strukturës përgjegjëse për licencimin, ministri

VENDOSI:

Refuzimin për dhënien e licencës për veprimtarinë “*Importi, eksporti, magazinimi i gazeve serrë të fluoruara, i pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose funksionimi i të cilave mbështetet në këto gaze*”, me kod III.3.B.1 ose/dhe për veprimtarinë “*Vendosja në treg e gazeve serrë të fluoruara, të pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose funksionimi i të cilave mbështetet në këto gaze*”, me kodin III.3.B.2, me të dhënat si më poshtë:

1. Nr. i refuzimit:

2. Emri i personit fizik/juridik që importon:

Numri i Kodit të Regjistrimit të Importuesit (Kodi UNIK):

NIPT-i:

Adresa (qyteti, rruga nr., etj.):

Nr. i telefonit:

Fax ose *email*-i:

Emri i drejtuesit teknik:

3. Arsyet e refuzimit:

;
MINISTËR

Emër Mbiemër
(*firma, vula*)